

BANKA E SHQIPËRISË: NJË DEKADË MË PAS.

1. NE VEND TË PARATHËNIES

Po lëmë pas vitin e dymbëdhjetë të tranzicionit. Ashtu sikurse dhe mjaft institucione të tjera, edhe Banka e Shqipërisë me përgjegjësitë e saj të shumta ka qenë dëshmitare dhe aktore e procesit të vështirë të transformimit ekonomik, politik dhe social të vendit, duke njohur në këtë mënyrë arritjet dhe dështimet e saj. Nuk do të tentoj të risjell përpara jush pasazhe dhe pjesë nga çdonjë prej ngjarjeve dhe zhvillimeve të shumta që kanë karakterizuar punën e Bankës së Shqipërisë në këtë dekadë, pasi do t'ju merrja shumë kohë. Megjithatë, ajo çka do të doja të fokusoja në vazhdim ka të bëjë me shtjellimin e disa prej momenteve më kyçe, të cilat vlerësohen se kanë qenë kontribuesit kryesorë në zhvillimin institucional dhe politik të Bankës së Shqipërisë.

2. BANKA E SHQIPËRISË, KORNIZA LIGJORE DHE ZHVILLIMI I SAJ INSTITUCIONAL

Krijimi i sistemit bankar dynivelësh u zyrtarizua me miratimin në Kuvend të ligjit nr.7559, datë 22.04.1992, "Për Bankën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr.7560, datë 22.04.1992, "Për sistemin bankar në Shqipëri".

Ligji "Për Bankën e Shqipërisë" i dha kësaj banke autoritetin për hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, për rregullimin dhe mbikëqyrjen e sistemit bankar duke përfshirë dhe licencimin e bankave të reja tregtare, për të emetuar monedhën në Republikën e Shqipërisë, për hartimin dhe rregullimin e politikave valutore të vendit etj.. Nga ana tjetër, ky ligj bëri kujdes që ta vishte institucionin e sapokrijuar me një shkallë të caktuar pavarësie, ku spikasnin mandatet e gjata të Guvernatorit, roli i Këshillit Mbikëqyrës, mënyra e zgjedhjes së tyre etj..

Pavarësisht vështirësive të fillimit, të cilat në njëfarë mënyre justifikoheshin me përgatitjen disi të ulët profesionale dhe me trashëgiminë e pakët në fushën e bankingut qendror si dhe të drejtimit institucional në përgjithësi, zhvillimi i Bankës së Shqipërisë në këta dhjetë vjet të ekzistencës së saj është përgjithësisht i prekshëm në të gjitha aspektet, ku pa dyshim baza ligjore, ajo nënligjore dhe kuadri institucional përbëjnë arritje.

Me kalimin e viteve baza ligjore dhe ajo rregullative kanë njohur përmirësime. Aktualisht, Banka e Shqipërisë e mbështet veprimtarinë e saj në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë (neni 161), në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 si dhe në një paketë të gjerë rregullatore që trajton probleme të veçanta që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e sistemit bankar, me transparencën, me licencimin e

subjekteve banka dhe jobanka, me kuadrin operacional, me administrimin e vlerave monetare dhe materiale etj.. Këtij insitucioni i njihet autoriteti për të hartuar dhe zbatuar, në mënyrë të pavarur, politikën monetare të vendit, objektiv final i së cilës është arritja dhe ruajtja e stabilitetit të çmimeve.

Ashtu siç e përmenda dhe më sipër, progres ka njohur dhe zhvillimi institucional i Bankës së Shqipërisë, ku përpjekjet kryesore u përqendruan në krijimin e një banke qendrore të fortë me shkallë të lartë të pavarësisë politike dhe të asaj ekonomike. Në ligjin aktual të Bankës së Shqipërisë, mishërohen standarde të avancuara në drejtim:

- të përcaktimit të saktë të marrëdhënieve të Bankës së Shqipërisë me buxhetin e shtetit. Në këtë pikë kemi pretendimin që në planin afatmesëm, në përputhje dhe me detyrimet që rrjedhin nga kërkesa për anëtarësim në BE të ndalohet me ligj kreditimi i kufizuar aktual i buxhetit nga ana e Bankës së Shqipërisë;

- të përcaktimit pa ekuivoke të ekskluzivitetit që ka Banka e Shqipërisë në hartimin dhe zbatimin e politikës monetare, ku në funksion të objektivit final i lihet Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë të gjykojë dhe të vendosë me vullnetin e tij mbi përqindjen bazë të interesit në ekonomi;

- të zgjedhjes, të afatit të qëndrimit në detyrë, të përcaktimit të rasteve të pezullimit nga detyra, të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, Guvernatorit dhe të administratorëve të tjerë të Bankës së Shqipërisë.

Megjithatë, eksperiencia e 10 viteve të shkuara, ka njohur dhe raste "të marrjes nëpër këmbë" të nivelit të pavarësisë ligjore duke bërë që pavarësia reale e Bankës së Shqipërisë të jetë akoma larg standardeve të përparuara.

Po kështu, besoj se nuk e ekzagjeroj, po të deklaroj se kapaciteti institucional, profesional dhe intelektual i Bankës së Shqipërisë, nga viti në vit ka ardhur duke u rritur. Aktualisht, ekzistojnë dokumente të shumta rregulluese që disiplinojnë praktikën e shumta të administrimit të rezervës valutore, të mbikëqyrjes, të borxhit të jashtëm të transparencës, të llogaridhënies, të operacioneve në treg, të administrimit financiar, të sigurimit etj., ndërkohë që thellimi në analizën e zhvillimeve ekonomike e financiare të vendit, ka bërë që gjykimi dhe vendimmarrja e Bankës së Shqipërisë të jenë të denja, të vlerësuara gjithnjë e më shumë nga publiku dhe nga institucionet e specializuara.

Banka e Shqipërisë, tashmë ka ndërtuar një kuadër të kënaqshëm transparence, duke u konvertuar në këtë mënyrë në një institucion të hapur për këdo të

interesuar. Megjithë formën ende jo të konsoliduar, kuadri i transparencës që ofrohet nga Banka e Shqipërisë, përfshin të gjitha aspektet e bankingut qendror duke filluar që nga publikimi i vendimeve e deri tek shpjegimi i vendimeve të marra. Për këtë qëllim, Banka e Shqipërisë ka ndërtuar dhe rrugët e realizimit të kësaj transparence që fillojnë me format më klasike, botimet e Bankës së Shqipërisë, e deri tek ato më bashkëkohore, faqja me një informacion të freskët në Internet.

Është përmirësuar dhe mënyra e llogaridhënies së Bankës së Shqipërisë. Debatet e zhvilluara në Parlament këto vitet e fundit, në reagim të raporteve vjetore të Bankës së Shqipërisë, kanë treguar se problematika e këtyre raporteve dhe fuqia shpjeguese e tyre ka ardhur në rritje duke rritur shkallën e sensitivitetit të të gjithë përfaqësuesve në Parlament. Megjithatë, Banka e Shqipërisë nuk ushqen iluzionin se çdo gjë është e përkryer dhe për më tepër ajo është e ndërgjegjshme se ka ende për të bërë në plotësim të standardeve dhe të praktikave më të mira ndërkombëtare. E ardhmja kërkon angazhim dhe përkushtim më të madh, sidomos po të marrim në konsideratë sfidat me të cilat vendi do të përballlet. Tashmë ne kemi vendosur që modeli institucional i së ardhmes për Bankën e Shqipërisë do të jetë Banka Qendrore Europiane, ndërkohë që objektivat e tjerë të politikave ekonomike dhe financiare na bëjnë të domosdoshëm një hop cilësor në drejtim të profesionalizmit.

3. BANKA E SHQIPËRISË: POLITIKA MONETARE DHE STABILITETI I ÇMIMEVE.

Debati mbi atë se çfarë mund dhe nuk mund të bëjë politika monetare vazhdon akoma. Në njërin krah qëndron mendimi se politika monetare, përveç stabilitetit të çmimeve duhet të vërë në shënjestrën e saj dhe punësimin dhe rritjen ekonomike. Mendimi alternativ fokusohet vetëm mbi stabilitetin e çmimeve. Megjithatë, të dyja teoritë bashkohen në idenë se politika monetare i shërben punësimin dhe rritjes ekonomike vetëm në qoftë se sigurohet stabiliteti i çmimeve. Pra, stabiliteti i çmimeve është një kusht i nevojshëm për rritje të qëndrueshme ekonomike dhe rrjedhimisht i vetmi objektiv i përshtatshëm i politikës monetare.

Në rastin e Bankës së Shqipërisë, ky debat është zgjidhur në favor të stabilitetit të çmimeve, një objektiv final i politikës monetare, i cili asnjëherë nuk është vënë në dyshim. Politika monetare, si një tërësi vendimesh dhe masash korrigjuese për një gjendje të dhënë të ekonomisë, ka synuar vendosjen e kontrollit mbi ofertën e parasë.

Që në momentin e parë u zgjodh një regjim i pastër i targetimit të parasë, ku si ancorë nominale u zgjodh baza monetare, rritja e së cilës do të kontrollohej

nëpërmjet aplikimit të disa kufizimeve sasiore në aktivet e Bankës së Shqipërisë, ndërkohë që si instrumente operacionale për kontrollin monetar ishin dy: kufiri i kredisë dhe përqindja e interesit¹ për depozitat në lekë të vendosura në bankat me kapital shtetëror.

Që nga korriku i vitit 1992 u adoptua një regjim fleksibël i kursit të këmbimit ndërkohë që transaksionet në llogarinë korente u liberalizuan plotësisht. Gjendja kritike, në të cilën ndodheshin rezervat valutore të vendit nuk lejonte një pjesëmarrje aktive të Bankës së Shqipërisë në treg dhe, për më tepër, aplikimi i një kursi këmbimi lirisht të luhatshëm gjykohej se do të shërbente si një rregullator automatik i pozicionit të përgjithshëm të bilancit të pagesave, në një kohë që dollarizimi i ekonomisë ishte në shkallë të lartë.

Këto masa, së bashku me adoptimin e një politike fiskale të shtrënguar dhe me liberalizimin e një pjese të madhe të çmimeve të konsumit, çuan në një frenim të menjëhershëm të zbalancimit të mëtejshëm të ekuilibrit makroekonomik. Inflacioni galopant i viteve 1990 – 1991 filloi të bjerë, shoqëruar me një stopim të rënies së mëtejshme të prodhimit etj.. Konsolidimi makroekonomik i vendit vazhdoi me hapa të shpejtë në vitet 1993 – 1995.

Rritja e menjëhershme e përqindjes së interesit dhe kontrolli i vendosur mbi kredinë për ekonominë bënë që të ndalohej hemorragjia e madhe monetare dhe në fund të vitit të vitit 1995 rritja e çmimeve të konsumit të ishte vetëm 6 për qind.

Periudha dyvjeçare në vijim, ku midis të tjerave si shkak të mundshëm do të veçoja dhe efektivitetin e ulët të sistemit bankar, përkon me zhvillimin dhe falimentimin e skemave piramidale. Përqindjet e larta të firmave "zëvendësuan" totalisht përqindjen e interesit të ofruar nga sistemi bankar e për rrjedhim efektiviteti i politikës monetare u bë pothuajse inekzistent. Përqindjet e larta çuan në prurje të mëdha depozitash në sportelet e këtyre firmave ndërkohë që investimi i tyre në prodhim dhe letra me vlerë ishte minimal krahasuar me shumën e mbledhur. Pamundësia e administrimit të depozitave nga ana e firmave bëri që këto të fundit t'i depozitonin ato në llogari rrjedhëse në bankat tregtare, duke ju krijuar atyre rezerva të tepërta në sasira të mëdha të cilat investoheshin në blerje bonosh thesari. Si rrjedhim, në fund të vitit 1996, inflacioni rezultoi 3 herë më i lartë nga viti paraardhës duke reflektuar një rritje të madhe të kredisë për qeverinë nga ana e sistemit bankar.

¹ Norma e interesit të depozitave me afat në lekë me maturim 12-mujor u rrit nga 2 – 3 për qind në bazë vjetore në nivelin 28 për qind.

Pasojat e falimentimit të firmave rentiere ishin të gjithanshme dhe për rrjedhim ato sollën dhe një faturë të madhe ekonomike. Në fund të vitit 1997, rënia e prodhimit u shoqërua me një përshpejtim të inflacionit, përkeqësim të pozicionit të jashtëm të vendit, dhe me shtim të papunësisë. Megjithatë, përpjekjet e bëra nga ana e Bankës së Shqipërisë duke rritur përqindjen e interesit në rreth 32 për qind filluan të jepnin frutet e tyre. Rezultatet e politikës monetare dhe të asaj fiskale u bënë më të prekshme në fund të vitit 1998, ku si pjesë e programit të Emergjencës Pas Konfliktit nënshkruar me FMN-në, përsëri u imponuan disa kufizime sasiore, më konkretisht në rritjen e rezervave valutore për neto, në rritjen e kredisë së Bankës së Shqipërisë për Qeverinë dhe në rritjen e kredisë neto të sistemit bankar për Qeverinë.

Periudha 1999 – 2000, regjistroi përqindje të pazakonta inflacioni për një ekonomi si ajo e Shqipërisë. Edhe pse gjatë vitit 1999 Shqipëria u detyrua të përballonte shpërnguljen biblike të popullsisë së Kosovës, përsëri inflacioni mbeti në kuota të ulëta. Duke filluar që nga ajo kohë e deri në fund të vitit 2000, përqindja e interesit u ul në mënyrë të vazhdueshme, por, megjithatë, në terma realë ajo mbeti e lartë. Nga ana tjetër, reagimi i tregut nuk ka qenë i menjëhershëm dhe kjo, përveç të tjerash, reflektohet edhe në diferencën e lartë që ka ekzistuar midis përqindjes minimale të interesit për depozitat me përqindjen e *yield*-it të bonove të thesarit. Në këto kushte, duke parë të arsyeshëm eliminimin e kufijve të poshtëm për depozitat me afat në lekë për bankat me kapital shtetëror, Banka e Shqipërisë synoi të shkelë një rrugë të re, atë të kontrollit monetar nëpërmjet tregut.

Tashmë mund të thuhet se ekziston një eksperiencë dyvjeçare në kontrollin e ofertës monetare nëpërmjet veprimeve në tregun e hapur të parasë. Që nga ky moment përqindja e interesit për marrëveshjet e riblerjes, siç po e tregojnë edhe zhvillimet e kohëve të fundit, po luan rolin e përqindjes bazë në ekonomi, duke demonstruar, kështu dhe një efektivitet më të lartë të mekanizimit të transmisionit monetar. Pa dyshim, ky fakt ilustron një maturim më të madh të aftësive të Bankës së Shqipërisë në vendimmarrjen e saj politike. Si refleksion i këtyre zhvillimeve është adoptuar edhe një kuadër operacional, ku spikasin ankandet javore të marrëveshjeve të riblerjes, të shoqëruara dhe me disa lehtësira të tjera ku veçoj depozitat dhe kreditë njëditore. Të gjitha këto zhvillime, kanë mundur rritjen e volumit të transaksioneve në tregun financiar, ashtu sikurse edhe numrin e pjesëmarrësve në të.

Rritja e efektivitetit të politikës monetare e kombinuar dhe me një sërë faktorësh të tjerë, ku do të veçoja konsolidimin fiskal të 2 – 3 viteve të fundit si dhe privatizimin e disa ndërmarrjeve të mëdha, vlerësohet se ka kontribuar në konsolidimin e ekuilibrit të përgjithshëm makroekonomik të vendit, sidomos në

periudhën, fund '98 – fund '01. Gjatë gjithë periudhës, rritja ekonomike e vendit ka regjistruar nivele të larta në harkun 7 – 8 për qind në terma realë, ndërkohë inflacioni vjetor në terma mesatarë është rreth 1.4 për qind. Përmirësim kanë njohur edhe përqindja e papunësisë, pozicioni i jashtëm i vendit etj..

Nga këndvështrimi politikës monetare, kontributi i saj është materializuar qartë në realizimin në vazhdimësi të të tre objektivave sasiorë të vendosur në programin monetar të Bankës së Shqipërisë.

Një arritje e këtyre viteve të fundit ka të bëjë me një gjallërim të aktivitetit kreditues nga sistemi bankar. Si dhe gjatë vitit 2001, kredia për ekonominë gjatë nëntëmujorit të parë të këtij viti, vazhdon të rritet me ritme të larta. Vetëm në tetëmujorin e vitit 2002 është akorduar rreth 38 miliardë lekë kredi, ndërkohë që në nivel vjetor kjo shifër pritet të arrijë rreth 58 miliardë lekë, që do të thotë rreth 17.5 miliardë lekë më shumë se viti i kaluar dhe rreth 8 miliardë lekë më shumë se gjithë kreditimi në periudhën 1993 – 1999.

Banka e Shqipërisë përveç politikës monetare harton dhe zbaton edhe politikën valutore të vendit. Deri në momentin aktual, Banka e Shqipërisë ka përshtatur një regjim të kursit të këmbimit, ku çmimi i lekut kundrejt monedhave të huaja përcaktohet lirisht nga forcat e tregut, kërkesa dhe oferta. Duke pasqyruar zhvillimet pozitive makroekonomike në këto pesë vite, kursi i këmbimit ka qëndruar relativisht stabil duke u luhatur mesatarisht në nivelin 140 lekë për një dollar. Rezervat valutore të Bankës së Shqipërisë kanë ardhur në rritje duke regjistruar nivelin 826 milionë dollarë amerikanë në fund të muajit nëntor 2002 krahasuar me 309 milionë dollare fund të vitit 1997, pra afërsisht janë trefishuar.

Megjithatë, ende nuk mund të thuhet në se kontrolli monetar është perfekt, fakt i cili në masë të madhe lidhet me gjendjen jo të zhvilluar të tregjeve në përgjithësi, ku do të veçoja pozicionin dominant të Bankës së Kursimeve si dhe ekzistencën e tregut informal të ekonomisë. Ky kontroll imperfekt i kombinuar me një varg goditjesh nga ana e ofertës, ku spikat kriza energjitike e dy viteve të fundit, si dhe për shkak të rikompozimit të shportës të çmimeve të konsumit ka bërë që inflacioni vjetor të vijë në rritje duke bërë që të rritet shqetësimi për realizimin e objektivit të çmimeve në fund të vitit 2002. Megjithatë, bazuar në pritshmëritë më të fundit të Bankës së Shqipërisë, ekziston besimi se edhe këtë vit ashtu si një vit më parë, do të bëhet e mundur që inflacioni vjetor në fund të

vitet të jetë rreth nivelit 4 për qind, pranë kufirit të sipërm të intervalit objektiv² të vendosur për vitin 2002.

4. BANKA E SHQIPËRISË: SISTEMI BANKAR DHE STABILITETI FINANCIAR I VENDIT.

Industria bankare në Shqipëri është relativisht e re. Bankingu i mirëfilltë tregtar, për herë të parë u krijua në pranverën e vitit 1992, megjithëse edhe më parë Banka e Shtetit Shqiptar kryente disa funksione të cilat ishin të njëjta me operacionet që kryen një bankë tregtare.

Në reformat e marra në vitin 1992 një pjesë të veçantë zinin dhe ndryshimet në sektorin financiar të vendit, sektor ky i cili në atë periudhë identifikohet me vetë sistemin bankar të vendit. Njëkohësisht, autoritetet ishin të angazhuara që të krijonin një ambient të përshtatshëm për tërheqjen e kapitalit të huaj në aktivitetin e bankingut tregtar, rezultat i drejtpërdrejtë i të cilit ishte krijimi, një vit më vonë, i dy bankave të para me pjesëmarrje të kapitalit privat, Bankës Italo Shqiptare³ dhe Bankës Arabo – Shqiptare Islamike⁴.

Megjithë zhvillimet e mësipërme, deri në mesin e viteve '90 e pak më tej, sistemi bankar vazhdonte të përfaqësonte një segment financiar jo të zhvilluar, me një dominim absolut të sektorit shtetëror në kushtet e ekzistencës së një infrastrukture shumë të varfër, duke manifestuar në këtë mënyrë mangësira në shërbimin në sportel. Kjo periudhë përkon edhe me shtimin e shpejtë të portofolit të kredive të këqija, të cilat në kushtet e ekzistencës së një mbikëqyrjeje joefektive dhe larg standardeve, të një mungese të theksuar të traditës dhe natyrisht edhe si pasojë e paaftësisë dhe shumë shkaqeve të tjera subjektive, krijuan probleme të mëdha në gjendjen financiare të të tre bankave shtetërore.

Të gjendur para kësaj situate, autoritetet e kohës duke filluar nga mesi i vitit 1997, dolën në konkluzionin se përveç, vendimeve të politikës monetare, për të krijuar një sistem bankar eficient dhe të sigurtë ishte e domosdoshme ndërmarrja e reformave të tjera duke filluar nga likuidimi i ndonjë banke "të pandreqshme" deri tek ndryshimet në legjislacion, rritjen e kapaciteteve mbikëqyrëse dhe licencuese etj..

² Që prej një periudhe 3-vjeçare Banka e Shqipërisë në fillim të çdo viti ka publikuar objektivin e inflacionit, i cili konsiston në mbajtjen e ndryshimit 12-mujor të indeksit të çmimeve në fund të vitit brenda intervalit 2 – 4 për qind.

³ Ndërmarrje e përbashkët midis BKT, Banca di Roma dhe BERZH.

⁴ Ndërmarrje e përbashkët midis BKT dhe Bankës Arabe për Zhvillim.

Ndër hapat e parë mund të përmend vendimin për likuidimin e Bankës Tregtare Agrare, krijimin e Agjencisë për Trajtimin e Kredive, nxjerrjen për privatizim të Bankës Kombëtare Tregtare dhe të Bankës së Kursimeve etj.. Po kështu, pas miratimit të ligjit të ri "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", paketa licencuese pësoi disa modifikime, ku bie në sy rritja e shumës së kapitalit të kërkuar si dhe heqja e diskriminimit për investitorët e huaj. Përveç çertifikimit të bankingut universal, Banka e Shqipërisë zgjeroi fokusin e veprimtarisë së saj licencuese edhe me shoqëritë e kursim-kreditit si dhe me institucione të tjera financiare jobanka.

Në rrjedhën e viteve me konsolidimin e stabilitetit politik, forcimin e rendit publik si dhe rivendosjen e shpejtë të ekuilibrit makroekonomik, gjykohet se është rritur atraktiviteti për kapitalin e huaj, i cili në vazhdimësi ka rritur praninë e tij në biznesin bankar në Shqipëri. Aktualisht, sistemi bankar në Shqipëri numëron 14 banka tregtare 2 herë më shumë se fundi i vitit 1996. Një zhvillim pozitiv përbën dhe fakti i rritjes së interesit të biznesit vendas në fushën e bankingut tregtar. Tashmë Banka e Shqipërisë po analizon aplikimet e para të biznesit shqiptar, për marrjen e lejes për të ushtruar aktivitet bankar në Shqipëri me kapital tërësisht vendas. Ndërkohë që sipas të dhënave⁵ më të fundit aktivitetet e sistemit bankar llogariten në rreth 53 për qind të prodhimit të përgjithshëm krahasuar me 45 për qind në fund të vitit 1998.

Vitet e fundit përveç zgjerimit, sistemi bankar ka njohur progres edhe në drejtim të shëndoshjes së gjendjes financiare. Për t'i konkretizuar më mirë arritjet, mjafton t'u referohemi shkurtimisht të dhënave të vitit 2002. Gjendja e sistemit bankar paraqitet e mirë dhe me tendencë në përmirësim pothuajse në të gjithë treguesit. Sistemi bankar është në vitin e katërt të tij që paraqitet me rezultat financiar pozitiv. Fitimi i realizuar në nëntëmuor rezultoi në masën 2.8 miliardë lekë krahasuar me 3.2 miliardë lekë humbje në fundin e vitit 1998.

Po t'i referohemi përsëri vitit 1998, aktivitetet e sistemit bankar janë rritur me 59 për qind ose në vlerë absolute për shumën 122 miliardë lekë. Një ndikim të ndjeshëm në rritjen e aktiveve kanë dhënë bankat me kapital privat dhe të përbashkët. Rritja e aktiveve të këtyre bankave, në krahasim me vitin 1998, është 120 miliardë lekë dhe vjen si rezultat i rritjes së besueshmërisë të këto banka e, për rrjedhojë, e afrimit pranë tyre të një numri më të madh klientësh, si dhe e shtrirjes së aktivitetit të tyre edhe në rrethe të tjera.

Në fund të muajit shtator 2002, teprica e kredive me probleme (bruto) zë vetëm 6.4 për qind të totalit të portofolit krahasuar me 32.7 për qind në vitin 1999.

⁵ Tremujori i tretë i vitit 2002.

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit për sistemin bankar rezulton 28.7 për qind ndërkohë që kapitalizimi është i lartë edhe në grupet e veçanta të bankave. Në këto raporte të larta të mjaftueshmërisë së kapitalit (norma minimale e mjaftueshmërisë është 12 për qind), krahas niveleve të larta të kapitalit, ka ndikuar ndjeshëm edhe struktura e aktiveve të sistemit bankar klasifikuar sipas rrezikut. Sistemi bankar vazhdon të evidentojë një nivel të lartë të investimeve në aktive pa rrezik apo me rrezik të ulët. Çdo ndryshim në strukturën e aktiveve në favor të aktiveve me rrezik të lartë, do të përmirësonte ndjeshëm raportin duke ndikuar njëkohësisht edhe në rritjen e fitimit, pa lënë mënjanë ndikimin në zhvillimin e sektorëve të ndryshëm të ekonomisë, nëpërmjet një kreditimi më të lartë.

Mjaft tregues, që konsiderohen si matës të likuiditetit paraqiten në nivele të kënaqshme. Një raport mjaft i ulët i tepricës së kredisë neto ndaj totalit të aktiveve (10.6 për qind), i tepricës së kredisë neto ndaj depozitave mesatare (12.8 për qind) si dhe fakti që 49.8 për qind e totalit të kredive janë kredi afatshkurtra, e përforcojnë konkluzionin e mësipërm.

Në përfundim, duhet të theksoj, që pavarësisht nga përmirësimi i treguesve, reforma e sistemit bankar duket se nuk po ecën me ritme të kënaqshme. Ky vlerësim lidhet me shtyrjen e procesit të privatizimit të Bankës së Kursimeve si dhe me nevojën për të zëvendësuar pronarin e Bankës Kombëtare Tregtare. Të dyja përfaqësojnë bankat më të mëdha të sistemit bankar dhe problemet që po shoqërojnë pronësinë e tyre, për fat të keq, do të ndikojnë në ecurinë e reformës së sistemit bankar dhe në gjallërimin më tej të aktivitetit të tij. Këto çështje kërkojnë vëmendje të plotë nga autoritetet përkatëse. Ndërkohë, miratimi i ligjit për sigurimin e depozitave është një hap pozitiv në drejtim të rritjes së mëtejshme të sigurisë së depozituesve dhe që do të ndihmojë edhe në rritjen e besimit në sistemin bankar.

5. PAK FJALË PËR SFIDAT NË DEKADËN E DYTË.

Për të qenë realist, më takon të them që eksperiencia e Bankës së Shqipërisë, shton sigurinë e orientimit të saj në të ardhmen. Gjithashtu, duhet të pranojmë se ambienti globalist në të cilin po jetojmë, e bën disi më të lehtë perceptimin e zhvillimeve të së ardhmes. Megjithatë, pa kaluar kufijtë e modestisë që me mirëdashje më lejojnë gjithë të pranishmit në këtë sallë, më takon të them që Banka e Shqipërisë, është megjithatë një institucion që meriton të synojë këtej e tutje në përsosjen e vizionit të saj për të ardhmen, sepse tashmë një të tillë realisht e ka.

Në këtë kontekst ne mbetemi thellësisht të angazhuar që të zhvillojmë më tej kuadrin aktual legjislativ, atë rregullativ si dhe kapacitetet e tjera të Bankës së Shqipërisë që kanë të bëjnë me hartimin dhe zbatimin e politikave monetare, me përsosjen e tregjeve dhe me rritjen e eficiencës së ndërhyrjeve në treg, forcimin e standardeve të mbikëqyrjes etj..

Më konkretisht, Banka e Shqipërisë në synimin e saj afatmesëm për të ndërtuar një model të ngjashëm me atë të Bankës Qendrore Europiane do të ketë parasysh:

- Stabiliteti financiar i vendit është konsideruar si një prioritet themelor për Bankën e Shqipërisë, për aq kohë sa sistemi bankar përbën segmentin më të rëndësishëm të sektorit financiar. Për këtë qëllim Banka e Shqipërisë, do të vazhdojë të rrisë **kapacitetin e saj mbikëqyrës dhe licencues** duke patur si objektiv afatmesëm konsolidimin e një sistemi bankar eficient, konkurrues, me shkallë të lartë të mbulimit të territorit etj..

- Banka e Shqipërisë mbetet e afirmuar në domosdoshmërinë e **thelimit dhe të çuarjes përpara të reformave në sistemin financiar në përgjithësi e atë bankar më në veçanti**. Nuk ka dyshim se sfida më e madhe e vitit të ardhshëm quhet Banka e Kursimeve, ndërkohë që ne vlerësojmë të një rëndësie të veçantë edhe gjetjen e një pronari të ri për Bankën Kombëtare Tregtare.

- Në lëmin e politikave, tashmë ne e kemi deklaruar se objektivi ynë strategjik do të jetë **adoptimi i regjimit të targetimit të inflacionit**. Tashmë kemi një eksperiencë në shpalljen e inflacionit objektiv, ndërkohë që edhe disa parakushte të tjera deri-diku janë të plotësuara. Megjithatë, në vitet që vijnë, angazhimi ynë do të konsistojë edhe në drejtime të tjera, të cilat vlerësohet të kenë një kontribut të madh në adoptimin e suksesshëm të këtij regjimi.

- **Konsolidimin e mëtejshëm të pavarësisë ligjore**. Kuptohet që përveç përafrimit të përkufizimit juridik të pavarësisë, do të shtohen përpjekjet për respektimin më rigoroz të saj në praktikën e përditshme. Ndoshta ka ardhur koha, të mendohet që në këtë moment për një ndalim të çdo forme huadhënieje të Bankës së Shqipërisë për buxhetin e shtetit. Dua të sjell në mendjen e të pranishmëve në sallë se një kriter i rëndësishëm i konvergjencës legjislative për çdo vend aspirant është pikërisht hartimi i një ligji për bankën qendrore në përputhje me rregullat e BE-së, ku në veçanti spikat pavarësia.

- Fuqizimi i mëtejshëm i pavarësisë nënkupton shtimin e përgjegjësisë të mëtejshme për Bankën e Shqipërisë, të cilat përpara së gjithash nënkuptojnë

transparencë dhe llogaridhënie më të plotë përpara publikut. Edhe pse progresi i kohëve të fundit është i prekshëm, ne mbetemi të angazhuar që të aplikojmë të plotë kodin e praktikave të mira mbi transparencën në politikat financiare dhe monetare.

- Hapja gjithnjë në rritje e Bankës së Shqipërisë në shpalljen dhe shpjegimin e vendimeve të saj politike, si dhe vetë synimet ambicioze të saj për të adoptuar në të ardhmen regjimin e targetimit të inflacionit, do të nxjerrë në pah domosdoshmërinë për një nivel më të lartë të profesionalizmit. Për këtë qëllim Banka e Shqipërisë, do të vazhdojë të aplikojë **politika të avancuara të menaxhimit të burimeve njerzore**, ku kualifikimit të mëtejshëm të personelit do t'i vihet një theks i veçantë.

Të nderuar të ftuar, pjesëmarrës, miq dhe kolegë!

Personalisht nuk kam mëdyshje se prezantimet, diskutimet dhe ndërhyrjet e bëra nga ana juaj gjatë punimeve të kësaj konference do të jenë një vlerë e re e shtuar në fondin e arritjeve të deritanishme.

Duke shpresuar se kontributi që ju do të jepni nga foltorja e kësaj konference, do të jetë i një rëndësie të veçantë, nuk më mbetet gjë tjetër veçse t'i uroj edhe një herë punë të mbarë kësaj konference.

BIBLIOGRAFIA:

“Strategjia e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë në afatin e mesëm”, Banka e Shqipërisë, viti 1999.

Raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë – viti 1992, 1995, 1996, 2000, 2001.

“Monetary Policy Frameworks in a Global Context” – përgatitur dhe përmbledhur për botim nga Lahavan Mahadeva and Gabriel Sterne – 1999.

Raportet Vjetore të Mbikëqyrjes, Banka e Shqipërisë, vitet 1998, 1999, 2001.

World Bank, *Albania Beyond Crisis*, 1998.

Cani, Sh., Muço, M., Baleta, T., *Sistemi Bankar në Shqipëri*, Gusht 2000.

Cani, Sh., *Financial Reforms in Albania*, 1995.